



Analizë e Raportit Vjetor 2017



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Analizë e Raportit Vjetor 2017 të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE)

“Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

Autor: Dardan Abazi

Bashkautor: Dora Musa

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Promovimi dhe inkurajimi i bashkëpunimit në mes të hisedarëve si mjet për instalimin e praktikës demokratike në vendimmarrje” dhe programeve për qeverisje demokratike dhe zhvillim të qëndrueshëm ka analizuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE). Kjo analizë është hartuar duke ndjekur metodologjinë e INDEP për analizimin e raporteve të agjencive dhe rregullatorëve të pavarur.

Instituti INDEP monitoron dhe mbështetë punën e Komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal që nga viti 2012. Fusha e energjisë si e tillë hyn në kuadër të programit të organizatës për zhvillim të qëndrueshëm. Duke qenë anëtar themelues i Konsorciumit Kosovar të Organizatave të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), INDEP ka qenë vazhdimisht i përfshirë në monitorimin e aktiviteteve të ZRRE-së dhe akterëve të tjerë në sektorin e energjisë në Kosovë.

Në vitin 2014, Komisioni parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri kishte harmonizuar një Manual për Raportim të Agjencive të Pavarura në Kuvendin e Kosovës. Ky dokument përmbante një pjesë të përgjithshme për të gjitha agjencitë dhe një pikë specifike për secilën nga agjencitë nën ombrellën e Komisionit. Pra, instrumenti fillestar i vlerësimit të raportit vjetor të ZRRE-së është përmbushja e kërkesave që dalin nga ky manual.

Analiza e raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji është organizuar në atë mënyrë që të jetë lineare me vet raportin. Raporti i ZRRE-së ka shtatë kapituj kryesor në të cilët shpjegohet funksioni, organizimi, aktivitetet, bashkëpunimi me palët e treta, raportimi financiar, energjia elektrike, termike dhe e gazit natyror. Duke ndjekur këtë ndarje, ne kemi organizuar hulumtimin parlamentar dhe analizën në të njëjtën mënyrë. Kjo analizë mëton që përmes vlerësimit të pavarur t’u ofrojë deputetëve një opinion shtesë dhe një depërtim më të thelluar të problemeve në sektorin e energjisë të cilat raporti i ka adresuar ose është dashur t’i adresoj.

Përveç manualit dhe analizës së raportit vjetor, një matricë vlerësuese e është përfshirë në Shtojcën 1 të kësaj analize. Kjo matricë në formë tabelore ka të listuara të gjitha aspektet për të cilat institucioni do të duhej të raportonte në bazë të Ligjit dhe kërkesave të manualit, dhe i kemi paraqitur nëse janë prezantuar në raport apo jo. Raportin është analizuar edhe në kontekst të zhvillimeve aktuale në sektorin e energjisë dhe rolit kushtetues dhe ligjor që ka ky institucion karshi këtyre zhvillimeve. Një analizë e përmbajtjes është bërë duke pasur në konsideratë të gjitha sfidat me të cilat në të vërtetë përballlet institucioni.

Organizimi institucional

Në pjesën e organizimit institucional, raporti ka përmbledhur kapacitetet e brendshme të zyrës përfshirë organogramin e ZRRE-së. Sidoqoftë ka nevojë të sqarohet më detajisht roli i drejtorit menaxhues për shkak se ligjërisht, Rregullatori udhëhiqet nga bordi i tij, i përbërë prej pesë (5)

anëtarësh, njëri prej të cilëve zgjidhet kryesues.¹ Pozita e drejtorit menaxhues në një institucion ku të gjitha kompetencat ekzekutive i ka bordi duket si punë e duplikuar dhe raporti ka nevojë të sqaroj se mbi çfarë

ZRRE ka drejtor menaxhues edhe pse ligji i'a jep të gjitha kompetencat ekzekutive bordit!

baze ligjore ZRRE-ja ka edhe bord ekzekutiv dhe drejtor menaxhues. Prandaj duhet sqaruar roli i këtij të fundit karshi bordit dhe organeve të tjera. Cila është nevoja e të pasurit një drejtor menaxhues në një institucion ku ligjërisht rolin e “menaxherit” e luan ekskluzivisht bordi!

Në raport është thënë: gjatë vitit 2017 janë mbajtur një varg takimesh rajonale, tryeza punuese dhe trajnime që kanë kontribuar në ngritjen e mëtejme të njohurive të punonjësve të ZRRE-së, mbi rregullimin e sektorit të energjisë në përputhje me standardet e BE-së.² Megjithatë, nuk është përmendur një listë e detajuar e trajnimeve dhe kapaciteteve të ngritura të stafit. Madje mungon edhe numri i saktë i trajnimeve të mbajtura dhe udhëtimeve të tjera. Informatat mbi trajnimin e stafit do t'i ndihmonin edhe kontrollit të shpenzimeve tek pjesa e raportimit financiar, por edhe për të pasur një pasqyrë të asaj se çfarë është bërë dhe çfarë duhet bërë më tutje në pjesën e ngritjes së kapaciteteve të stafit të rregullatorit.

Aktivitetet e ZRRE-së

Në raport, ZRRE përmend përparimet në bazën ligjore përfshirë kompletimin e listës së rregulloreve që kanë dalë si rezultat i ndryshimit të ligjit në vitin 2016. Megjithatë, nuk është raportuar nëse është hasur në ndonjë vështirësi në zbatimin e pakos së ligjeve të energjisë të miratuara në vitin 2016, dhe nëse këto ndryshime kanë mundur të implementohen pa pengesa. Një opinion i ZRRE-së në lidhje me stadin e zbatimit të pakos së tretë të legjislacionit që rrjedhë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë do të ishte shumë i nevojshëm për punën e mëtejme të Komisionit parlamentar.

Në pjesën e licencimit të aktiviteteve të energjisë, ZRRE ka raportuar se për furnizimin e konsumatorëve me pakicë ka të licencuar tre furnizues, mirëpo i tërë furnizimi i konsumatorëve në vend është bërë nga KESCO, ndërsa furnizuesit tjerë të licencuar HEP dhe GSA gjatë tërë vitit kanë qenë pasivë për sa i përket furnizimit të konsumatorëve.³ Duke qenë se kjo ndërlihet drejtpërdrejtë me procesin e liberalizimit të tregut, ZRRE këtu është dashur të japë më shumë detaje në lidhje me atë se përse këta dy furnizues nuk kanë qenë aktiv. A i kanë përmbushur të gjitha obligimet operatorët e tjerë në treg për të mundësuar operimin e këtyre furnizuesve duke marrë parasysh edhe faktin që konkurrenti KESCO, që aktualisht mban monopolin, është nën pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS). A ka ZRRE të rregulluar se çka ndodhë nëse një operator i tillë është pasiv, dhe cilat janë implikimet në një treg të hapur siç ne synojmë të arrijmë! Këto çështje nuk janë të adresuara në këtë pjesë të raportit.

Për më tepër, sipas ZRRE-së gjatë vitit raportues është bërë modifikimi i licencave, gjithmonë në përputhje me ndryshimet e pësura në legjislacionin e sektorit të energjisë elektrike. Mirëpo, në

¹ Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L-084 Neni 5, Bordi, Emërimi, dhe Përbërja, Prishtinë: GZRKS.

² Zyra e Rregullatorit për Energji, (2018), Raporti Vjetor i Punës për vitin 2017, faqe 13, Prishtinë: ZRRE.

³ Ibid, faqe 16.

raport mungojnë të dhënat e detajuara rreth këtyre licencave dhe furnizuesve konkret. Gjithashtu, mungojnë informata se si këto modifikime kanë ndikuar tek furnizuesit dhe prodhimtarinë e tyre të energjisë elektrike.

Në pjesën e licencimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë ZRRE ka raportuar se Ministria e Zhvillimit Ekonomik në Maj të vitit 2017 ka rishikuar Udhëzimin Administrativ për Caqet e BRE-ve, Nr. 01/2013 dhe ka nxjerr aktin e ri nënligjor për caqet e BRE në (MW) që do të ndërtohen deri në vitin 2020, dhe ndryshimet e vetme janë (Energjia Fotovoltaike është rritur nga 10 MW sa ishte me UA nr. 01/2013 në 30 MW kapacitet të instaluar dhe Biomasa nga 14 MW sa ishte në 20 MW.⁴ Ky ndryshim i rëndësishëm nuk është komentuar fare në raport. Pjesa më e rëndësishme që duhet adresuar është nëse ZRRE është konsultuar mbi këto ndryshime dhe nëse është marrë për bazë mendimi i saj! A janë zhvilluar procese të brendshme konsultative siç e parasheh ligji dhe cili do të jetë ndikimi i këtij vendimi në tregun energjisë! Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë Elektrike thekson qartë faktin se caqet përcaktohen për periudhë dhjetë vjeçare dhe se të gjitha institucionet duhet të jenë të informuara:

Institucionet e përfshira në promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë do të sigurohen se informatat mbi masat përkrahëse do t'i vihen në dispozicion të gjithë akterëve relevantë, siç janë: konsumatorët, ndërtimtarët, instaluesit, arkitektët dhe furnizuesit e pajisjeve të ngrohjes, ftohjes dhe energjisë elektrike që shfrytëzojnë energji nga burimet e ripërtëritshme.⁵

Licencimi i operatorëve për prodhim të energjisë nga BRE-të

Në këtë raport, ZRRE ka raportuar më detajisht në lidhje me aktivitetet e licencimit të operatorëve për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtëritshme sesa herëve të kaluara. Megjithatë, ekziston një problem i madh që ka të bëjë me numrin e vogël të licencave përfundimtare për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese. Edhe në të kaluarën janë paraqitur shqetësime në lidhje me faktin që një pjesë e madhe e operatorëve marrin licenca preliminare, por nuk i realizojnë deri në fund investimet ose marrin shumë kohë deri në realizimin e investimeve.

ZRRE duhet të përfshijë një tabelë të detajuar të licencave e cila përfshinë kohëzgjatjen e afateve të secilës prej këtyre licencave dhe kapacitete e instaluar. Nuk mjafton të raportohet vetëm për vitin paraprak, por për të paktë tre vitet e fundit. Në përmbajtje të raportit ose në shtojcat e tij duhet të paraqiten të gjitha licencat aktive të lëshuara, kohëzgjatja e tyre dhe kohën kur do të skadojnë. Gjithashtu, për operatorët të cilët janë në fazën preliminare të marrjes së licencës, duhet cekur në raport se kur priten që MW e deklaruar të futen në sistemin energjetik. Këto informata janë të rëndësishme për të parë se ku qëndron sektori në përgjithësi dhe se a ka nevojë që të bëhen ndryshime të atilla që të mundësojnë zhbllokimin e kapaciteteve në fushën e energjisë së ripërtëritshme.

⁴ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2018), Raporti Vjetor i Punës për vitin 2017, faqe 18, Prishtinë: ZRRE.

⁵ Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L-081 për Energjinë, Neni 15 – Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, faqe 58, Prishtinë: GZRKS.

Duke konsideruar kompleksitetin e sektorit të energjisë dhe në mënyrë që ky raport të jetë i kuptueshëm dhe lexueshëm për çdo palë, pasqyrimi i lokacioneve të këtyre kapaciteteve të reja gjeneruese në harta të veçanta për secilën kategori të burimeve të ripërtëritshme, solare, erës dhe ujit, do t'i kontribuonin jashtëzakonisht këtij raportit.

Paditë ndaj ZRRE-së

ZRRE ka raportuar se gjithashtu është përballur me disa padi përfshirë padinë nga KESCO SH.A., për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ZRRE-së V_860-2016 të datës 14.10.2016, për licencimin e shoqërisë HEP-KS SH.P.K., për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike. ZRRE duhet të sqaroj më tepër se për çfarë padie bëhet fjalë dhe se cilat do të jenë implikimet në rast se paditësit i fitojnë këto raste. Fakti që si duket KESCO nuk është e gatshme të pranoj konkurrent në tregun e furnizimit me energji elektrike, tregon sa e rëndësishme është që ZRRE të monitoroj tregun e energjisë elektrike dhe sidomos gatishmërinë e KEDS që të kryej obligimet për asistencë teknike dhe gatishmëri të ofrimit të shërbimeve për operatorët e rinj në tregun e furnizimit. Informata shtesë duhen dhënë edhe për paditë e tjera të listuara në raport.

Nxitja e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE

Tek pjesa e nxitjes së prodhimit të energjisë elektrike nga BRE-të është raportuar vetëm me një paragraf mbi konsumatorët prodhues, më saktësisht mbi trajtimin e tyre si mikro-gjeneratorë. ZRRE në kuadër të Rregullës për skemën mbështetëse ka trajtuar edhe energjinë e prodhuar nga mikro-gjeneratorët (gjeneratorët me vete-konsum) të cilët mund “të shtyjnë” tepricat e energjisë së prodhuar në rrjet dhe të marrin atë energji në kohën që i duhet.⁶ ZRRE duhet të raportoj nëse konsumatorëve që kanë investuar në prodhim të energjisë elektrike ju janë instaluar orët dy drejtimesh dhe nëse po kompensohen për energjinë që e fusin në rrjet. Kjo përgjegjësi e KEDS-it tashmë është dashur të implementohet dhe është përgjegjësi e ZRRE-së t'i raportoj Kuvendit nëse kjo e fundit po mbështetë konsumatorët mikro-gjeneratorë ose po i pengon ata. Gjithashtu, në raportin duhet të demonstrojë se sa prej MW të prodhuara nga BRE-të janë paguar në tarifat nxitëse.

Bashkëpunimi me palët e tjera dhe mbrojtja e konsumatorit

Me anë të raportit, ZRRE është lënduar se ka bërë konsultimin me të gjitha palët kur ka marrë vendime. Por kur në mars të vitit 2017 ZRRE kishte propozuar ndryshimin e strukturës tarifore, me ç'rast u hoqën blloqet tarifore në bazë të konsumit dhe në bazë të sezoneve, INDEP përmes KOSID kishte kundërshtuar një strukturë të tillë. Ne i kishim prezantuar faktet tona duke argumentuar se ky ndryshim do të shkaktonte rritje të çmimit për konsumatorët më në nevojë dhe do të rriste kërkesën për energji. Mirëpo, asnjëherë nuk morëm përgjigje me shkrim se cilat kanë qenë arsytet se përse nuk u morën parasysh argumentet tona.

Në raport thuhet: procesi i ndryshimit të strukturës tarifore të energjisë elektrike është paraprirë nga publikimi i dokumentacionit dhe përfshirja e të gjitha palëve të interesuara, qoftë përmes

⁶ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2018), Raporti Vjetor i Punës për vitin 2017, faqe 38, Prishtinë: ZRRE.

komentimeve me shkrim, seancave dëgjimore si dhe takimeve të veçanta, me Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Odën Ekonomike, OJQ-të e tjera si dhe komunikimet me mediat dhe konsumatorët.⁷ Përfshirje e palëve nënkupton përgjigje me shkrim për komentet të cilat janë bërë dhe jo vendime arbitrare dhe të marra me shpejtësi. Në këtë kuptim, ne konsiderojmë që kjo pjesë nuk është paraqitur në mënyrë objektive.

Për ne, në skandalin e faturave të veriut ZRRE ka shkelur drejtpërdrejtë Ligjin Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe atë së paku dy të drejta bazë të konsumatorit:


- Të drejtën për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorit,
- Të drejtën për informim dhe edukim të konsumatorit.⁸

Përderisa, humbjet në komunat veriore tashmë janë paraqitur shumë më qartë në këtë raport sesa në raportet e kaluara vjetore të ZRRE-së, ky institucion duhet të mbahet përgjegjës që ka dështuar të informoj drejtë konsumatorët dhe ka kamufluar humbjet e veriut për vite të tëra.

Raportimi financiar

Edhe pse në parim raportimi financiar konsiderohet më tepër përgjegjësi e Komisionit funksional për Mbikëqyrje të Financave Publike, për INDEP, pjesa financiare ndihmon të shpjegohen edhe aktivitetet në përmbushje të rolit dhe misionit që ZRRE ka. Janë tre gjëra thelbësore në raport që nuk janë adresuar siç duhet:

1. Të hyrat e derdhura në Buxhetin e Republikës së Kosovës/Taksat e dedikuara



Në raport thuhet që ZRRE financohet nga të hyrat e dedikuara, që mbledhen nga taksat e inkasuara nga të licencuarit në bazë të nenit 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.⁹ Megjithatë, nga 1,4 milion euro sa mbledhë ZRRE në emër të taksës së dedikuar, vetëm 592,128.02 euro janë ndarë për ZRRE-në.

Të hyrat nga taksat e dedikuara i nënshtrohen

parimit juridik të ekuivalentit të mbledhjes së taksës me qëllimin për të cilin mbledhen.¹⁰ Meqë

⁷ Ibid, faqe 52.

⁸ Republika e Kosovës, (2012), Ligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, Neni 4 – Të drejtat e konsumatorit, Prishtinë: GZRKS.

⁹ Zyra e Rregullatorit për Energji, (2018), Raporti Vjetor i Punës për vitin 2017, faqe 14, Prishtinë: ZRRE.

¹⁰ Abazi, Dardan, Hollaj, Learta, (2016), Analizë e politikave, Taksat e dedikuara në Kosovë - çka po marrim në këmbim të pagesës?, Prishtinë: INDEP

buxheti për ZRRE-në është dukshëm më i vogël sesa taksat që mbledhen, këto të fundit duhet menjëherë të zvogëlohen për të reflektuar kostot operationale të Rregullatorit. Nëse mbledhen taksa në emër të një qëllimi/shërbimi të caktuar dhe ato derdhen në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës (pra në mënyrë bizare trajtohen si tatime), këtu kemi të bëjmë me shkelje thelmore të të drejtave të qytetarëve dhe pjesëmarrësve në tregun e energjisë të cilët vjedhen me duke ua keqpërdorur paratë.

ZRRE urgjentisht duhet të zvogëlojë taksat e dedikuara në atë mënyrë që të reflektojnë me buxhetin që ky rregullatorë ka. Vetëm në atë mënyrë do të mbrohej parimi i ekuivalentit dhe barazisë në vendosjen e taksave publike. Një problem i ngjashëm ekziston edhe tek taksa rrugore, taksa ambientale, taksa e sigurisë në aeroport etj. Ne kemi ngritur këtë çështje vazhdimisht dhe konsiderojmë që është një nga vrimat e zeza të menaxhimit të financave publike në Kosovë në të cilën qytetarët e Kosovës janë viktimë.

2. Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit (si mëditjet, akomodimit, etj.)

Si institucion me rëndësi të veçantë në sektorin e energjisë i cili ka nevojë të vazhdueshme të marrë pjesë në takime të rëndësishme jashtë vendit me institucione dhe organizata ndërkombëtare që janë edhe si pikë referimi për sfidat me të cilat ky sektor po ballafaqohet është e kuptueshme se shpenzimet e udhëtimeve zyrtare janë të pa evitueshme. Sido që të jetë, çfarë është shqetësuese në raportin e vitit paraprak të ZRRE-së janë shifrat e larta të mëditjeve të shpenzuara për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Kjo vlerë është 31% më e lartë se shumica monetare e shpenzuar për akomodim, e që shpesh herë ndodhë të jetë e kundërta. Për shkak që mëditjet nëpër vende të ndryshme arrin vlera të veçanta, në raport do të duhej të bëheshin të qarta pjesëmarrja e personave në këto udhëtime si dhe lokacionet ku stafi i ZRRE-së ka përfaqësuar institucionin. Së fundmi, raportit do t'i kontribuonte shumë edhe informatat dhe shpenzimet e ngarkuara rreth takimeve të Komunitetit të Energjisë, takime këto që janë të rregullta për disa vite tani për ZRRE-në.

3. Shpenzimet e shërbimeve të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, anëtarësimit dhe përfaqësimit

Në raport përmenden se institucioni në fjalë ka pasë nevojë të kontraktojë persona për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, shpenzimet e të cilave kontraktime janë bërë publike në seksionin e raportimit financiar të raportit. Mirëpo, demonstrimi në detaje të këtyre shërbimeve do ta kishte rritur akoma edhe më shumë nivelin e transparencës të këtij institucioni. Prandaj, shpjegimet se për çfarë lloj shërbimesh bëhet fjalë, kush kanë qenë personat e kontraktuar, dhe se si ata kanë kontribuar në performancën e institucionit janë të nevojshme.

Përpos shpenzimeve të shërbimeve intelektuale dhe këshillëdhënëse, në raport shumë pak informata jepen rreth shpenzimeve të anëtarësimit. Listimi i këtyre anëtarësimeve përpos që do ta bënte të qartë se në çfarë organizata është prezente ZRRE-ja, kjo do të shërbente si pikë referuese për planifikimin e anëtarësimeve të tjera të nevojshme për vitet e ardhshme. Për më tepër, shpenzimet për përfaqësim mbeten të paqarta se për çfarë lloj përfaqësimi bëhet fjalë, qoftë nëpër takimet me institucionet e tjera publike lokale apo gjykatë.

4. Vlera e lartë e qirasë së ndërtesës aktuale të institucionit dhe shpenzimet kapitale

Raporti financiar i ZRRE-së shfaq edhe shpenzimet e ngarkuara për qiranë e hapësirës fizike të institucionit. Duke konsideruar vlerën e shpenzuar për këtë qira në raport me buxhetin e përgjithshëm të institucionet, ajo përbën 7.2% të tij. Në mënyrë që shpenzimet mbi qiranë të zvogëlohen, do të ishte mirë që bordi të rishqyrtonte opcionin e qëndrimit të stafit në objektin aktual të institucionit. Gjithashtu, në raport paraqiten shpenzimet kapitale, respektivisht një software, për të cilin nuk jepen detaje se për çfarë programi bëhet fjalë dhe arsyen pse pikërisht ai program është blerë.

5. Ndikimi i zvogëlimit të buxhetit në aktivitete

ZRRE ka raportuar për zvogëlim të buxhetit në masën 10.90%. Në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale janë shkurtuar 58 mijë e 800 euro. Këto informata nuk janë pasuar nga analiza e impaktit që ka pasur zvogëlimi i buxhetit në kryerjen e rolit që ka Rregullatori. Nëse afër 11% e buxhetit është zvogëluar, çka ka mbetur pa u realizuar si pasojë e kësaj dhe si ka ndikuar kjo në aktivitetin e Rregullatorit. Nëse s'ka pasur fare ndikim, ndoshta nuk ka pasur fare nevojë të planifikoheshin në fillim!

6. Mungesa e analizës krahasimore.

Buxheti i mungon një analizë krahasimore me vitet e kaluara. Kjo ka rëndësi sidomos për të prezantuar shpenzimet kapitale dhe shpenzimet e tjera në një kontekst krahasimor. Buxheti i krahasuar mundëson edhe vendimmarrje më të lehtë në kohën kur diskutohet Ligji për Buxhetin. Në të kaluarën, komisioni funksional ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e bie fjala projekteve të ndryshme kapitale të agjencive të pavarura.

Energjia Elektrike

Energjia elektrike zë një pjesë të madhe të raportit të ZRRE-së. Që në fillim jepet një statistikë e




Figura 1. Kapacitetet prodhuese te linjtit dhe BRE-ve ne 5 vitet e fundit


rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike. 7.5% e kapacitetit prodhues në Kosovë në vitin 2017 ka qenë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Siç shihet në figurë, kurba e kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme ka filluar të ngritet dhe linjiti ka filluar të bjerë. Për transformimin e pashmangshëm të sistemit energjetik, ky është një lajm shumë i mirë.

Përshkrimi që në fillim i është bërë liberalizimit të tregut si prioritet dhe se si është shpjeguar detajisht procesi i shturjes dhe synimeve për të ardhmen na ka bërë shpresëdhënës. Megjithatë, krahas kësaj, ZRRE lavdëron nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e termocentralit nga linjiti dhe madje shpjegon si ky termocentral do t'i japë Kosovës “pavarësi energjetike” dhe është ndërtuar “sipas standardeve dhe kritereve të BE-së”. ZRRE duhet që krahas kësaj, të shpjegojë se si do ta realizoj liberalizimin e tregut në kohën kur njërit prodhues në treg (Kosovës së Re), do t'i blihet e garantuar e gjithë energjia 24 orë në ditë për 20 vjet! Cila do të jetë pozita në treg e kësaj kompanie në një treg të liberalizuar? Këtë, raporti, nuk e shpjegon.

Raporti përmend problemet me shpronësimin në Shipitullë dhe shpjegon se si ka pasur rrënie të prodhimit të linjtit për këtë shkak. Megjithatë, në raportin e vitit të kaluar asnjë nga këto probleme nuk janë përmendur. Mbetja pa rezervë të linjtit dhe pa mundësi të prodhimit nuk ka qenë situatë e paparashikueshme. Përse nuk është raportuar më parë dhe çka ka bërë ZRRE-ja për të evituar dëmtimin e konsumatorit përmes importit të shtrenjtë e reduktimeve të shpeshta!

Çmimi mesatar i energjisë elektrike në vitin 2017 është rritur për 6% me ndryshimin e strukturës tarifore.

Me ndryshimin e strukturës tarifore është rritur çmimi mesatar i energjisë elektrike! Këtë shqetësim të INDEP, të cilin e patëm shfaqur në kohën kur ndryshimi është bërë, e ka vërtetuar raporti vjetor. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjar është ngritur nga 5.71 në 6.04 €/cent kWh dhe për konsumatorët jo familjar nga 7.92 në 7.94 €/cent kWh.



Edhe pse në raport është paraqitur vetëm me shifra të çmimit mesatar, rritja është edhe më e madhe për konsumatorët që kanë harxhuar më pak se 600 kW në muaj. Për ta, në bazë të analizës së INDEP rritja e kostos së energjisë elektrike me strukturën e re tarifore është për deri në 30% më e lartë.

Energjia Termike dhe e Gazi Natyror

Të dhënat sa i takon energjisë termike janë të kufizuara kryesisht në të dhënat nga Termokosi dhe Ngrohitorja e Gjakovës. Nuk jepen të dhëna më të përgjithshme të tilla si: sa % e qytetarëve janë të kyçur në rrjete të ngrohjes qendrore, cili është potenciali për zgjerim në të ardhmen dhe cilat janë mundësitë për më shumë sisteme të ngrohjeve qendrore. Në pjesën e gazit natyror është shpjeguar vetëm projekti ALKOGAP me Shqipërinë dhe nuk ka të dhëna mbi infrastrukturën aktuale të trashëguar, nivelin e investimeve që nevojiten dhe se si është e organizuar industria e gazit natyror aktualisht (për aq nivel të konsumit sa kemi). Prandaj, informatat e paraqitura në këtë seksion duhet të jenë po aq të detajuara sa ato të energjisë elektrike. Për më tepër, duhet paraqitur një rregullore në bazë të së cilës për ditë dhe temperatura të caktuara bëhet kyçja apo shkyçja e ngrohjes qendrore.

Përfundime

Si përfundim, mund të thuhet se raporti i sivjetmë i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka një përmirësim nga vitet e kaluara. Transparencë më e madhe është shfaqur në paraqitjen e të dhënave dhe në ndarjen e qartë të humbjeve komerciale të përgjithshme nga humbjet në veri të Kosovës. Në anën tjetër, me gjithë shumësinë e të dhënave, jo të gjitha janë paraqitur drejtë dhe jo gjithçka është sqaruar tërësisht.

Në pjesën e organizimit institucional, është me rëndësi që raporti t'i sqaroj disa gjëra. ZRRE udhëhiqet nga bordi i cili ka rolin e plotë dhe të vetëm ekzekutiv. Në të njëjtën kohë, organogrami tregon se institucioni ka një Drejtor Menaxhues roli i të cilit është i pasqaruar. Çfarë kërkon një drejtor menaxhues në një institucion që ka bord ekzekutiv dhe kryesues të bordit?! ZRRE duhet ta sqaroj këtë në raport në mënyrë që të shihet nëse ka nevojë për një pozitë të tillë ose jo. Gjithashtu, një varg informatash mungojnë sa i takon burimeve njerëzore të stafit të ZRRE-së. Duhet plotësuar të dhëna sa i takon përgatitjes profesionale, trajnimeve të kryera në të kaluarën si dhe gjatë vitit 2017 dhe të shpjegohet në cilat drejtime ka nevojë për më tepër ngritje të kapaciteteve.

Analiza gjeti se ka informata të pa plotësuara ose të plasuar në mënyrë jo të qartë edhe në pjesën e raportimit të aktivitetëve të ZRRE-së. Raportohet se dy nga tre furnizuesit në treg janë pasiv dhe se KESCO ka monopolin faktik dhe shpjegohet se për licencimin e njërit nga këta furnizues KESCO ka paditur ZRRE-në, por nuk shpjegohen arsyet përse këta furnizues nuk zhvillojnë aktivitet. Flitet për rritje të caqeve për burime të ripërtëritshme me vendim të Ministrit dhe nuk sqarohet nëse ZRRE ka qenë pjesë e procesit dhe se cili është qëndrimi i ZRRE-së për këtë.

ZRRE duhet të paraqesë të gjitha licencat aktive në fushën e BRE-ve. Kur janë dhënë, çfarë lloji licencash janë, kur u skadon afati dhe kush është pronar i tyre. Vetëm kështu, do të mund të kishim një pasqyrë të qartë të gjendjes dhe të ndihmohej procesi i zhbllokimit të kapaciteteve dhe nxitjes së investimeve të vërteta.

ZRRE duhet të sqaroj në praktikë se a ka filluar të implementohet konsiderimi i konsumatorëve prodhues si mikro-gjeneratorë dhe ofrimi i mundësisë për shtytje të energjisë në rrjetë dhe kompensim i saj në faturë. Nuk mund të thuhet se thjeshtë është trajtuar ose ka hyrë në fuqi një rregull e tillë e të mos thuhet nëse KEDS dhe akterë të tjerë kanë filluar t'a implementojnë këtë. Në të njëjtën kohë, duhen ofruar statistika për investitor shtëpiak të cilët jo domosdoshmërisht janë të lidhur me skemat mbështetëse.

Kur ZRRE konstaton se ka pasur vazhdimisht bashkëpunim me palë të treta dhe i ka konsultuar në vendime, duhet të sqaroj përse as nuk ka shqyrtuar kërkesat e INDEP dhe KOSID me rastin e propozimit të ndryshimit të strukturës tarifore. Ky ndryshim i strukturës tarifore sipas këtij raporti ka shkaktuar rritje të çmimit mesatar të energjisë elektrike për 6%. ZRRE duhet të raportoj sa % të komenteve të marra nga palët e treta i ka marrë parasysh në procesin e vendimmarrjes dhe sa % të komenteve që nuk janë marrë parasysh kanë marrë përgjigje prapa.

Në të njëjtën kohë, ZRRE ka raportuar se i është zvogëluar buxheti për afër 11% dhe nuk ka dhënë asnjë informatë mbi ndikimin që ky zvogëlim ka pasur në performancën e rregullatorit dhe kryerjen e misionit që ka. Raporti financiar shfaq shpenzimet e shërbimeve intelektuale dhe këshillëdhënëse, anëtarësimit dhe përfaqësimit, por ai nuk jep informata të mëtutjeshme në lidhje me përmirësimin e punës brenda institucionit. Për shkak që shpenzimet e mëdijëve gjatë vitit raportues dukshëm lënë mbrapa ato të akomodimit, në mënyrë që raporti të jetë akoma më transparent dhe kredibil duhet të paraqet edhe numrin e udhëtimeve, vendeve dhe qëllimin e këtyre udhëtimeve. Gjithashtu, bordi i ZRRE-së duhet të konsideroj faktin se qiraja aktuale e hapësirës fizike të institucionit merr 7.2% të buxhetit total, dhe të arsyetojë nëse ka marrë për bazë mundësinë e ndërrimit të objektit. Tek shpenzimet kapitale duhet të bëhet e qartë se çfarë software është blerë dhe për çfarë qëllimi.

ZRRE në këtë raport krahas prioritizimit të liberalizimit të tregut, pozicionohet qartazi pro kontratës me Contour Global-in e cila do të bëjë që për 20 vite pas fillimit të prodhimit, Kosova të detyrohet të blejë nga njëri operatorë në treg. Në qoftë se ZRRE bënë avokatin e Qeverisë dhe arsyeton një projekt me shumë pikëpyetje, ndoshta në raport duhen sqaruar edhe këto pikëpyetje për deputetët dhe opinionin e gjerë. Çfarë do të ndodhë me tregun e liberalizuar kur një kompanie do t'i garantohet çmimi dhe shitja e 100% të energjisë së prodhuar? Si është e mundur që një kompani e tillë të ketë përparësi të dispeçimit në një treg të integruar rajonal të energjisë?

Çmimi mesatar i energjisë elektrike ka shënuar rritje dhe kjo nuk është sqaruar aspak nga raporti. Ne jemi të bindur që ky ndryshim ka ardhur si rezultati ndryshimit arbitrarë të strukturës tarifore, proces i cili për kategoritë që kursenin energjinë, rriti çmimin e saj deri në 30%. Si gjithmonë, Kosova importon me çmime shumë më të shtrenjta sesa që eksporton. Një listë e tregtimit të energjisë elektrike, importit dhe origjinës së të gjithë energjisë së importuar duhet t'i bashkëngjitet raportit.

Shumë më tepër nevojiten të dhëna sa i takon energjisë termike dhe gazit natyror. Nevojiten informata mbi potencialet për të ardhmen dhe kapacitete ekzistuese. Rrjeta e ngrohjes dhe infrastruktura e trashëguar e gazit duhet të paraqiten në formë harte dhe gjithashtu të prezantohen pikat kryesore ku investimet janë të domosdoshme.

Shtojcë 1 – Formë vlerësimi e përmbajtjes së raportit

		<i>Po</i>	<i>Jo</i>	Koment
1	Përmbledhje ekzekutive	X		
	a. Pikave kryesore të cilat elaborohen në raport	X		
	b. Arritjet e agjencisë për vitin e raportimit	X		
	c. Objektivat për vitin e ardhshëm		X	
2	Baza Ligjore, Permirosimet dhe Veshtiresite	2/3 X		Vështirësitë nuk ceken!
	a. Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të institucionit	X		
3	Përshkrimi i Institucionit	X		
	a. Misioni / Vizioni dhe Kompetencat	1/2 X		Vështirësitë nuk ceken!
	b. Departamente përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore që i përkasin kompetencave	X		
4	Organizmi institucional	X		
	a. Raportimi për organizimin e brendshëm të institucionit (bordi, ekzekutivi, deri te personeli)	X		
	b. Puna e bordit gjatë vitit raportues		X	
	c. Organogrami; Hapësira fizike dhe lokacionit; Deklarimi I mungeses se infrastruktures se nevojshme fizike	1/3X		Hapësire fizike dhe mungesa e infrastrukturës mungon!
	d. Asetet		X	
5	Përshkrim i Tregut/Fushën që e mbulon institucioni	X		
	a. Krahasimi i tregut për me se paku tri vitet paraprake dhe planeve për vitin vijues		X	
	b. Çka ka ndërmarrë Institucioni që të përmirësohet/monitorohet tregu/fusha e veprimit		X	
	c. Sfidat e vitit paraprak dhe planifikimi për vitin vijues		X	
6	Puna gjatë vitit paraprak	X		

	a. Punet specifike që agjencia i ka bërë gjatë vitit raportues	X		
	b. Detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjit	X		
	c. Sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak (te arsyetohen ato që nuk janë arritur)		X	
7	Raporti financiar	X		
	a. Raporti i buxhetit me shpenzime	X		
	b. Të ndahen rrogat nga mëditjet		X	Pagat dhe mëditjet janë të paraqitura në një linjë buxhetore!
	c. Ndikimi i buxhetit në punën e Institucionit		X	Thotë se është zvogëluar nga viti paraprak por nuk shpjegohen ndikimet në punën e institucionit.
	d. Planifikimi / Realizimi i buxhetit	X		
	e. Investimet kapitale	X		
	f. Tabelë krahasuese me buxhetin e tri viteve paraprake		X	
	g. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve	X		
	h. Vizitat jashtë vendit, mëditje, akomodim, numri i udhëtimeve dhe personave që kanë marrë pjesë	X		Nuk jepet numri i sakte I udhëtimeve dhe personave që kanë marrë pjesë në këto udhëtime!
8	Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm		X	

	a. Tabela duhet paraqitur me komentet dhe rekomandimet e ZAP dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga ana e institucionit		X	
9	Anekset		X	
	a. Të dhënat për vendimet dhe lëshimin e licencave		X	Gjate raportit ka te dhëna por jo te detajuara, përpos numrit te licencës dhe afatit te skadimit.
	b. Të dhëna shtesë për informatat e përgjithshme të shtjelluara në raport		X	
10	Analizë e zhvillimeve brenda fushëveprimit të funksioneve (rezultatet e monitorimit mbi zhvillimet e konkurrencës dhe transparencës në tregjet e energjisë në Kosovë)		X	
11	Përmbledhja e të gjitha vendimeve individuale të ndërmarra dhe vendimet mbi zgjidhjen e kontesteve dhe procedurat përmbartimore të ndërmarra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë gjatë vitit të kaluar		X	
12	Të dhënat mbi të licencimin dhe aktivitetet tjera rregullative gjatë vitit paraprak	X		
13	Raportin e audituar financiar të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin paraprak, përfshirë këtu shumën e te hyrave të mbledhura nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë si dhe shpenzimet e bëra		X	
14	Përmbushja e obligimeve dhe detyrimeve të parapara me ligj si kompetenca të kësaj zyre		X	
15	Licencat (të kategorizuar në kategoritë e paraqitura në Nenin 27, paragrafin 2) dhe detajet specifike të lëshimit të tyre duhet të jenë pjesë ndër më qendroret të raportimit të ZRRE	X		
	a. Arsyetime rreth refuzimit të kërkesave për licencim, si dhe specifika rreth licencave të revokuara, të bartura apo të pezulluara	X		
	b. ZRRE duhet të japë edhe krahasime me vitet paraprake		X	
16	Konsulentët dhe këshilltarët e jashtëm të angazhuar nga ZRE për të ndihmuar gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të saj, si dhe alokimi buxhetor për angazhimin e tyre	X		Nuk shfaqen te dhëna për alokimin buxhetor te

				angazhimit te tyre!
17	Masat e ndërmarra për të parandaluar keqpërdorimin e pozitës dominuese ose për përmbylljen, apo tentativën për të përmbyllur një marrëveshje të një të licencuari e cila ka për qëllim apo efekt kufizimin apo çrregullimin e konkurrencës		X	
18	Masat e ndërmarra për të parandaluar apo mënjanuar rrethanat që rrezikojnë kapacitetin e të licencuarit për të përmbushur obligimet e tij për shërbimin publik		X	
19	Masat e ndërmarra për të parandaluar apo mënjanuar subvencionimin e tërthortë ndërmjet aktiviteteve të licencuara		X	
20	Ankesat e pranuar nga konsumatorët kundër të licencuarve, nga të licencuarit kundër të licencuarve të tjerë, si dhe në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmisionit, apo shpërndarjes së energjisë elektrike, ngrohjes së përqendruar apo gazit natyror dhe transmisionit, rrjedhave ndërkufitare të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Gjithashtu, të raportohet lidhur me procedurat e hartuara për zgjidhjen e këtyre kontesteve.	X		
21	Të hyrat nga taksat për modifikimin dhe ndryshimin e licencave si dhe aplikacionet tjera për licenca, taksa fillestare dhe vjetore të licencimit, taksa për lëshimin e certifikatave të origjinës, si dhe nga zgjidhjet e kontesteve administrative		X	
22	Konsultimet me publikun të organizuara nga ZRrE	X		Vetëm përgjithësisht!
23	Vendimet mbi miratimin e tarifave për shërbimet e rregulluara të energjisë; Të përshkruhen edhe ankesat në lidhje me tarifat dhe metodologjinë e tarifave			
24	Imponimet e shërbimit publik mbi ndërmarrjet energjetike	X		E pasqaruar!
25	Të bëmat e ZRrE-se që kanë synuar mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit dhe mbrojtjen e mjedisit	X		
26	Gjobat e caktuara	X		

“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.